



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION, TË
MBAJTUR MË 18.12. 2013**

**DHJETOR
2013**

Mbledhjen e kryeson anëtarja e Komisionit për Legjislacion, znj. Albulena Haxhiu.

KRYESUESJA: Atëherë, po fillojmë!

Faleminderit shumë, që jeni sot bashkë me neve në këtë dëgjim publik në lidhje me Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit.

Po i them unë fillimisht disa fjalë, sa i përket këtij projektligji e më pas ndoshta edhe profesori do ta marrë fjalën, por edhe ju që jeni këtu do ti thoni vërejtjet e juaja konkrete lidhur me këtë projektligj.

Unë po e them edhe njëherë, që Kosova nuk vuan nga mospasja e ligjeve, mirëpo nga moszbatueshmëria e atyre ligjeve në praktikë. Pra, ne kemi në fuqi Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, mirëpo fatkeqësisht që ai ligj nuk po zbatohet nga institucionet, të cilat janë të thirrura që t'i zbatojnë këto ligje.

Pra, ne dimë tashmë shumë raste ku Agjencioni Kundër Korrupsionit, për mendimin tim, ka vepruar me standarde të dyfishta duke mos e parandaluar konfliktin e interesit tek personat konkret, rasti i Betim Gjoshit dhe rasti i Sllobodan Petroviqit, i cili për dy vjet radhazi ka qenë edhe anëtar Bordi në AKP dhe zëvendëskryeministër dhe ministër dhe Agjencioni Kundër Korrupsionit nuk e ka ndërmarrë asnjë veprim për ta parandaluar atë konflikt.

Ministri i Drejtësisë në kohën kur është miratuar në parim ky projektligj foli në atë mënyrë, që kush e di se sa ndryshime janë bërë, mirëpo për mendimin tim, ndryshimet që janë në këtë projektligj janë tejet teknike. Pra, ajo që po ndryshohet është termi “zyrtar të lartë” të zëvendësohet me “persona zyrtarë” dhe nuk janë specifikuar, pra kategoritë, ashtu siç ka kërkuar Shoqëria Civile, mirëpo neni katër i Projektligjit kur personi zyrtar pra nuk është specifikuar pra veç e veç si në ligjin aktual, por vetëm sa i është përshtatur. Pra, është bërë një harmonizim me Kodin e ri Penal dhe çështja e afatizimit.

Pra, për mendimin tim, ky projektligj ka shumë mangësi, të cilat edhe më tutje do ta vështirësojnë punën e Agjencionit Kundër Korrupsionit, për ta parandaluar konfliktin e interesit. Dhe, nuk mendoj që ky projektligj do të avancojë pra, ose do ta parandalojë konfliktin e mundshëm të interesit tek

personat zyrtarë. Mirëpo, ashtu po thuhet nga Ministria e drejtësisë dhe unë shpresoj që sot do t'i kemi edhe qëndrimet e tyre karshi këtij projektligji.

Pra, unë kaq kam për fillim. Ndoshta, profesori do ta marrë fjalën, apo...

HAKI DEMOLLI: Fillimisht, përshëndes kryetaren e grupit punues dhe kolegun tjetër Armendin, i cili sapo erdhi dhe ju falënderoj të gjithë pjesëmarrësve. Të gjithë juve që keni gjetur kohën dhe keni treguar gatishmërinë, që të jeni të pranishëm sot në këtë dëgjim publik, si quhet.

Dhe, të them të drejtën, ne si grup punues jemi caktuar nga ana e Komisionit për Legjislacion. Në njëfarë forme na është besuar mënyra e punës që ne të vendosim se si të punojmë dhe jemi përcaktuar që të kemi edhe këtë dëgjim publik, me qëllim që t'i kemi edhe qëndrimet e juaja.

E vërtetë është ajo se ne si Kosovë, jo vetëm në rrafshin e konfliktit të interesit, por edhe në të gjitha sferat thuajse kemi legjislacion të mjaftueshëm, madje – madje nesër ne do të debatojmë në Kuvend, pikë debati e kemi edhe raportin e progresit, dhe atje në shumë vende kam parë se ekziston një konkluzion i hartuesve të raportit të progresit, se Kosova ka legjislacion, por problemi është te zbatimi apo avancimi i zbatimit, ose tentimi, ose orvatja apo përpjekja për zbatimin e këtyre ligjeve.

Dhe, natyrisht takimet e kësaj natyre, çfarë është sot, nuk kërkojnë që ne të flasim shumë, por ne thjeshtë ju kemi thirrur juve, që t'i kemi qëndrimet e juaja, t'i kemi mendimet e juaja, t'i kemi bindjet e juaja, e pastaj ne si grup ato mendime i shohim, i analizojmë, lidhur me nenet përkatëse apo lidhur me dispozitat dhe lidhur me tërë projektligjin, që është në fjalë. E pastaj, ne ato i harmonizojmë në formë të amendamenteve dhe ato të cilat vlerësojmë, se duhet t'ia përcjellim komisionit e komisioni pastaj i përcjellë në Seancë.

Kështu që unë nuk do ta kisha zgjatur më shumë, vetëm ju kisha falënderuar me shpresë dhe dëshirë, që ju ta ndjeni veten sa më mirë dhe sa më lirë, që të na jepni mendimet e juaja lidhur, bazuar qoftë në përvojat institucionale, po qoftë edhe nga qasjet tjera që keni gjatë hartimit të legjislacionit, sidomos po flas për ju të Ministrisë së Drejtësisë, por edhe përfaqësuesit tjerë, që të na japin përvojat e tyre, në mënyrë që ato t'i inkorporojmë në formë të amendamenteve dhe dispozitave përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, profesor! Armend e do fjalën, apo mandej? Mirë, atëherë kush e do fjalën? Po, zëvendësministër. Dhe, ju lutem që të mos e zgjasni më shumë se ndoshta, 10 minuta, për shkak se i duam propozimet konkrete në mënyrë që të na lehtësohet puna mandej neve në grupin punues.

Edhe për ju të tjerët që e merrni fjalën, prezantoheni ju lutem, për shkak të transkriptit na duhet. Faleminderit!

DAUT XHEMAJLI: Faleminderit!

E nderuar kryetare e grupit,

Të nderuar anëtarë dhe ju të pranishëm,

Më lejoni që në pika të përgjithshme t'i paraqes disa çështje që kanë për bazë ta arsyetojnë qëllimin dhe rëndësinë si dhe përmbajtjen e këtij projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Miratimi i këtij projektligji për neve paraqet, ose ndryshimet në këtë projektligj, për neve paraqet edhe një prej prioriteteve dhe angazhimeve tona, me qëllim të harmonizimit të dispozitave ligjore dhe shmangien e konfliktit ligjor, pas datës 1 janar 2013. E keni parasysh, hyrjen në fuqi të Kodit Penal dhe të Kodit të procedurës penale të Kosovës.

Ne, pas vlerësimit të infrastrukturës ligjore në fuqi kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit, dispozitave të këtij kodi, kodit penal dhe kodit të procedurës penale, pas pranimit të rekomandimeve nga raporti i fundit për studimin e fizibilitetit për Kosovën, sugjerimeve nga ekspertë dhe institucione vendore dhe ndërkombëtare, si dhe kërkesat e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në koordinim të plotë me gjithë këta faktorë kemi hartuar dhe po paraqesim këto propozime për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ky projektligj i hartuar ka tri qëllime kryesore:

1. Qëllimi i parë ka të bëjë me harmonizimin e këtij projektligji me Kodin Penal dhe Kodin e procedurës penale, sipas të cilëve sanksionet për veprën e konfliktit të interesit janë rritur në masë të

dukshme dhe në raste të caktuara kjo vepër është kualifikuar si vepër penale për herë të parë, me ç'rast parashihet edhe dënimi me burgim.

2. Qëllimi i dytë ndërlidhet me përmbushjen e rekomandimeve, që dalin nga raporti i studimit të fizibilitetit për Kosovë, Komisionit Evropian, që lidhen pikërisht me rritjen e sanksioneve për këto dy vepra penale: tejkalimi i pasurisë; dhe konflikti i interesit; si dhe për të përsosur edhe më tutje kornizën ligjore kundër korrupsion.

Sanksionet për këto vepra penale janë rritur, është krijuar baza ligjore dhe procedura ligjore të përshtatshme, për çka besoj që nuk është punë e jonë, por besoj që ju mbetet institucioneve të tjera, Prokurorisë dhe gjykatave, që të jenë të pakompromis në luftën, ndjekjen dhe gjykimin e cilitdo person që ka vepruar në konflikt të interesit.

3. Qëllimi i tretë ndërlidhet me përmbushjen e kërkesave për të plotësuar dhe ndryshuar kornizën e tanishme ligjore, e cila është rezultat i këtyre konsultimeve të gjata, që kemi pasur me këta aktorë: Agjencinë Kundër Korrupsion, përfaqësuesit e Prokurorisë e gjykatave, zyrën e Bashkimit Evropian, EULEX-in, Ambasadën Amerikane, përfaqësues të shumtë të Shoqërisë Civile, që kanë qenë prezentë në këto takime.

Pra, ky propozim-ndryshim është një produkt i përbashkët i krejt këtyre mekanizmave, cilësia e të cilëve, sipas nesh, është shumë e mirë dhe fare pak mund të ketë hapësirë për ndonjë plotësim eventuale.

Me këtë rast unë, e përmendi edhe deputeti që konkluzionin e raportit të progresit për vitin 2013, të publikuar nga Komisioni Evropian, ku me të drejtë thuhet që Kosova në masë të madhe ka krijuar kornizë të nevojshme legjislative kundër korrupsionit. Por, besoj që e keni parasysh që edhe propozimet, ndryshimet eventuale në përsosjen e tij janë të domosdoshme.

Prandaj, kjo është edhe një përpjekje jona, që të miratojmë këtë propozim-ndryshim dhe të tregojmë se jemi të përkushtuar për perfeksionimin e kornizës kundërkorrupsion dhe të krijojmë parakushte për rritjen e efikasitetit të institucioneve tona për të luftuar këtë dukuri.

Pra, pa e tepruar, ne pas kësaj presim edhe veprime edhe rezultate konkrete nga institucionet tjera. Ne në këtë drejtim po kryejmë obligimet tona. Besoj

që përmes këtij projektligji edhe e keni parasysh besoj, që i kemi shtuar edhe një obligim të rëndësishëm për Agjencinë Anti korrupsion, duke paraqitur për të një detyrim shumë të qartë ligjor, përmes së cilës Agjencia obligohet të parashtojë të gjitha kallëzimet penale pranë prokurorisë kompetente në rastet kur vërehet apo dyshohet nga ana e saj, se një person zyrtar gjendet në konflikt interesi.

Përmes kësaj dispozite kemi inkurajuar dhe obliguar për aktivitet më të shtuar nga ana e Agjencisë Kundër Korrupsion, gjë që padyshim besojmë që do të rezultojë edhe me shumë kallëzime penale, më shumë ndjekje dhe rrjedhimisht presim më shumë gjykime në këtë fushë, domethënë nga gjykatat e caktuara.

Ministria e Drejtësisë si prioritet kryesor ka pasur krijimin e kornizës së nevojshme legjislative, për të parandaluar konfliktin e interesit për të luftuar korrupsionin dhe për këtë qëllim ka hartuar këto dispozita shumë më të qarta ligjore, përmes të cilave obligojmë Agjencinë Antikorrupsion, Prokurorinë, gjykatat e Kosovës, që të parandalojnë, ndjekin dhe gjykojnë personat në konflikt të interesit.

Ky projektligj besojmë se do të ketë efekt shumë më të theksuar preventiv ndaj dukurisë së konfliktit të interesit, në veçanti dhe korrupsionit në përgjithësi, sepse rritja e sanksioneve, patjetër se ka për të ndikuar në rritjen e kujdesit të personave zyrtarë, që bien në fushëveprimtarinë e këtij ligji, si dhe ngritjen e përgjithshme të vetëdijes shoqërore lidhur me këtë dukuri dhe për më tepër, besojmë që ky projektligj do të kontribuojë edhe në rritjen e nivelit të besimit dhe sigurisë së qytetarëve në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe tregon qartë përkushtimin e institucioneve tona të Kosovës, për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

I kemi parasysh të gjitha ato që u thanë në kuptim të asaj që ne nuk jemi ata që zbatojmë këtë legjislacion, po besojmë që është i domosdoshëm intervenimi në ndryshimet dhe në përmirësimin e këtij legjislacioni, sidomos në këtë fushë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Xhemajli!

Sa për sqarim, ne kemi shumë vërejtje nga shoqëria civile dhe Agjencia e kundër korrupsionit, të cilat i janë adresuar Komisionit për Legjislacion, konkretisht grupit punues.

Pra, ju thatë që ky është një produkt i përbashkët, përmendët disa faktorë, ku ndër të tjerë edhe Agjencinë dhe Shoqërinë Civile, mirëpo unë me përgjegjësi të plotë them që nuk janë marrë parasysh vërejtjet e Agjencisë kundër korrupsionit e as të shoqërisë civile, vetëm të Agjencionit Kundër Korrupsionit kemi 10 këtu para nesh, të cilat ju nuk i keni marrë parasysh.

Dhe, tash ne si Komision për Legjislacion, ose si grup punues nuk guxojmë që të prekim në ligjin aktual, për shkak se për të prekur ligjin aktual duhet nismë e re legjislative. Ne duhet të fokusohemi vetëm në këtë projektligj, kështu që na e keni vështirësuar mjaftë punën, sepse nuk i keni marrë parasysh vërejtjet e tyre.

ALBULENA HAXHIU: Arton!

ARTON DEMHASAJ: Faleminderit!

Jam Arton Demhasaj prej organizatës “Çohu”. Fillimisht duhet të them që është në rregull që shoqëria civile ka marrë pjesë në takimin që e ka organizuar Ministria e Drejtësisë sa i përket këtij projektligji, mirëpo ne kur kemi marrë pjesë në ato grupe punuese që janë organizuar nga UNDP-ja ne e kemi pas këtë draft përpara.

E gjithë ajo çka kemi mundur të bëjmë ka qenë që ne mund të propozojmë ndonjë ndryshim sa i përket këtij draftit që unë e quaj me plot përgjegjësi teknik dhe nuk kemi mund të bëjmë propozime për ndryshimin e ligjit që është aktual, ligjit që është në funksion tash.

Domethënë, Ministria e Drejtësisë e ka hartuar këtë projektligj, i ka hartuar këto ndryshimet teknike ose s'mund të them plotësime, sepse plotësimi nuk përmban, por përmban vetëm ndryshime. Atëherë, ne nuk kemi pasur të bëjmë asgjë sa i përket ligjit, por kemi mundur të bëjmë propozime vetëm për me e ndryshu qit draft ligj edhe sot e kemi përpara.

Domethënë, unë konsideroj që fillimisht Ministria e Drejtësisë së bashku me Agjencinë Kundër Korrupsionit është dashur që ta marrin një iniciativë për me bë një analizë sa i përket ligjit aktual që është, për me i pa se ku janë ngecjet që nuk po mundet ky ligj domethënë me e luftu parandalimin e konfliktit të interesit, në atë mënyrë që masandej kur të fillon ndryshimi ose plotësimi i Ligjit për konfliktin e interesit pastaj të merren parasysh ato

fusha ku ka ngecje edhe të bëhen ndryshimet dhe plotësimet në ato fusha që domethënë të mos ketë hapësirë për me u keqinterpretua ligji.

E them këtë për arsye, sepse ligji aktual por edhe tash ky ligji për plotësim ndryshim nuk i ka rregulluar disa çështje. E para është nuk e ka bë klasifikimin e konfliktit të interesit karshi pozitive ose niveleve të zyrtarëve të lartë publik. Domethënë, ky ligj parasheh që të gjithë zyrtarët e lartë publik prej atyre më të ultë deri tek ata më të lartë të jenë një kategori. Nuk i ka kategorizu qysh i kanë edhe vendet e rajonit ku kanë shumë nivele të konfliktit të interesit karshi pozitive, nivelit të zyrtarëve të lartë.

Pra, si presidentja e vendit ose kryeministri, si një zyrtar i ultë janë të konsideruar në mënyrë të barabartë me këtë ligj. E neni 9 për plotësim ndryshim të këtij projektligji parasheh që personat zyrtarë nuk mund të jenë menaxhues, kontrollues, apo anëtarë të organizatave menaxhuese në organizatat fitimprurëse ose jo fitimprurëse përjashtuar subjektet politike.

Kjo nënkupton që të gjithë zyrtarët e lartë në bazë të këtij ligji mund të jenë anëtarë ose në organet udhëheqëse të partive politike që bjen në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, për arsye se presidentja nuk mund të jetë as anëtare e organeve të partive politike në organet drejtuese, por as udhëheqëse e partisë politike. Kjo është krejt si pasojë e mos kategorizimit të konfliktit të interesit karshi pozitive, niveleve të zyrtarëve të lartë.

Domethënë, ky është një prej atyre që mundet ky ligj. Pastaj, kjo pjesa e nenit 12 të Ligjit për plotësim ndryshim ku thotë që agjencia ushtron kallëzim penal, për mendim timin kjo nuk është në rregull për arsye se sipas Kodit të procedurës penale e Prokuroria e shtetit ose prokuroritë tjera kompetente janë të obliguar në bazë të këtij kodit që ... të iniciojnë procedurën për hetim në rast të dyshimit për ndonjë vepër penale që mund të lidhet vepra penale për konflikte të interesit.

... agjencia të bëjë hetime deri për me e bind veten më së pari që është konflikt i interesit pastaj te ushtron një kallëzim penal ta qon në prokurori, prokuroria derisa ta merr kallëzimin penal në shqyrtim që ka mundësi edhe me u parashkrua krejt ajo lëndë penale se edhe në prokurori po parashkruhen lëndët penale duke u lënë mos u marr me u shqyrtu, pse prokurori mos me pas domethënë obligim ligjor qysh e ka në bazë të Kodit

Penal që ajo eksoficio ose sipas detyrës zyrtare ta nis edhe ta hetojë një rast të dyshimtë për konflikt të interesit.

Gjithçka mundet agjencia me bë është me e dërguar një raport me shumë raste që mund të jenë dyshim, domethënë për konflikt të interesit ta qojë në prokurori edhe prokuroria të nis hetimet sipas detyrës zyrtare.

Edhe unë prapëseprapë mendoj që ky projektligj që kemi sot për plotësim ndryshim nuk i përmbush të gjitha kushtet që Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit Nr. 04 051 që është në funksion domethënë që t'i përmbushë të gjitha ato mos zbatueshmëri që i ka pas ky ligj, pra nuk i përmbush të gjitha kushtet që ligji të jetë shumë funksional në të ardhmen.

Mendoj se prapëseprapë vitin tjetër ka me pas edhe iniciativë tjetër për plotësim ndryshim sepse ky më shumë merret me çështje teknike, jo me çështje esenciale që ligji ka pas problem në zbatueshmëri. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, Arton!
Përfaqësuesi i Agjencionit Kundër Korrupsionit.

FRASHËR MURTEZAJ: Faleminderit, kryesuese!
Për të gjithë ata që nuk më njohin jam Frashër Murtezaj, jam shef i Divizionit për parandalimin e konfliktit të interesit në Agjencionin Kundër Korrupsionit.

Në fillim desha me ju thënë pak fjalë lidhur me procesin për fillimin e hartimit të Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit.

Agjencia Kundër Korrupsionit në momentin që është futur në fuqi Ligji penal i Kosovës, ka vërejtur se ligji aktual mbi parandalimin e konfliktit të interesit është në kundërshtim dhe bie në kundërshtim me disa pika që për ne kanë qenë shqetësuese. Pas kësaj, Ministria e Drejtësisë ka futur në strategjinë dhe janë mbledhur grupet mes dy institucioneve tona që të punojnë në këtë ligj.

Ka qenë kërkesa e agjencisë që në fillim që të nxirret një ligj i ri për shkak që në praktikë është më lehtë të punohet, për shkak se puna jonë në ndryshim plotësimet e ligjeve të mëhershme na ka sjell probleme të ndryshme.

Gjatë kësaj pune nuk kemi gjetur përkrahjen e Ministrisë së Drejtësisë për të nisur, për tu bërë një ligj i ri. Agjencia gjatë grupeve punuese ka dhënë kontributin e vetë si institucion që është zbatues i ligjit përkatës duke bërë propozimet për çështje konkrete që kanë dalë gjatë praktikës në zbatimin e këtij ligji. Disa nga propozimet e ... janë futur në projektligjin i cili është miratuar nga Qeveria e Kosovës, mirëpo disa nga propozimet tona nuk janë marrë parasysh.

Andaj, edhe gjatë kësaj kohe kemi dërguar propozimet tona që të futen në projektligj në Qeveri për arsye që të kemi një ligj më të mirë dhe më funksional në zbatim. Edhe në takimin e fundit që kemi pasur jemi marrë vesh që të mos ... në ligjin aktual i cili është në fuqi mirëpo, vetëm në projektligj sipas procedurës që është në Kuvend.

Agjencia ka nxjerr disa rekomandime dhe kërkesa të cilat duhet të futen në projektligjin aktual, të cilat janë deleguar edhe te Komisioni për Legjislacion e cila ndoshta është mirë që të ndalem te secila pikë veç e veç për arsye se tek të gjitha i kemi vërejtur edhe nevojën pse duhet futur në projektligj.

Nëse më lejohet mund të filloj prej pikës së parë se shumica prej juve i keni materialet që i kemi dërguar.

Lidhur me çështjen e përcaktimit të fushës së zbatimit të ligjit dhe rrethit të personave ndaj të cilëve zbatohet. Po i numëroj në fillim 10 pikat që të fokusohemi pastaj tek secila veç e veç.

1. Është çështja e përcaktimit të fushës së zbatimit të ligjit dhe rrethit të personave ndaj të cilëve zbatohet ky ligj
2. Çështja e përfitimeve të shërbimeve
3. Çështja e ushtrimit të veprimtarisë në arsimin e lartë publik
4. Çështja e transferit të të drejtave në ndërtim të ndërmarrjes
5. Çështja e ushtrimit të funksioneve ... nga bartësit e funksioneve në sistemin e drejtësisë,
6. Çështja e punësimit të zyrtarëve në dy e më shumë institucione,
7. Çështja e mbledhjes së fakteve për trajtimin e konfliktit të interesit
8. Çështja e dëmit të shkaktuar nga vendimet e marra në ... konfliktit të interesit,

9. Çështja e njoftimit të agjencisë nga autoriteti kontraktues për aktivitete të prokurimit publik, si dhe
10. Çështja e mbajtjes së regjistrit për rastet e konfliktit të interesit.

Janë të gjitha këto pika që agjencia është ndalur dhe i ka analizuar secilën një nga një, ku edhe i ka përshkruar arsyetimin për secilën pikë.

Nëse më lejohet mund të filloj nga pika e parë.

Çështja e përcaktimit të fushës së zbatimit të ligjit dhe rrethit të personave ndaj të cilit zbatohet ligji. Në nenin 4 të projektligjit është paraparë që ky ligj do të zbatohet ndaj të gjithë personave zyrtarë të definuar sipas dispozitave të Kodit Penal. Sipas definimit të dhënë në nenin 120, paragrafi 2 dhe neni 424 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, personi zyrtar nënkupton: personin e zgjedhur ose të emëruar nga një organ shtetëror, personi i autorizuar nga një organ shtetëror, organizatë biznesi ose ndonjë person ... juridik i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerr në pajtim me ligjin ushtron detyrë të posaçme dhe 3, personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj.

Në fakt kjo zgjedhje e propozuar tejkalon edhe qëllimin e vetë ligjit, sepse parimisht ligji ka për qëllim që të parandalojë rastet e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik. Zyrtarët e lartë publik janë persona që potencialisht mund të bijnë në konflikt të interesit sepse kanë pozitat të caktuara vendimmarrëse, kurse personat tjerë zyrtarë shumë rrallë ose fare nuk vijnë në shprehje të kenë rol vendimmarrës.

Sipas Kodit Penal person zyrtar nënkupton personat e zgjedhur, të emëruar, si dhe çdo person të cilit i është besuar ndonjë detyrë ose funksion në një institucion shtetëror dhe publik. Në fakt, personi zyrtar në kuptim të këtij neni është çdo person që ushtron ndonjë detyrë për ndonjë institucion.

Nëse ... kjo zgjedhje ashtu siç është propozuar do të jetë problem identifikimi i rasteve, si dhe mundësitë për t'i trajtuar të gjithë personat zyrtarë do të jetë e vështirë për agjencinë.

Agjencia propozon që rrethi i personave të lartë publik, të cilët parasheh Ligji për deklarimin e pasurisë dhe dhuratave të jetë i njëjtë edhe për Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Në mbështetje të këtyre fakteve, agjencia propozon që rrethi i personave

ndaj të cilët zbatohet ligji të jetë i njëjtë sikurse në nenin 3 të Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për deklarimin e pasurisë.

Apo ndalemi ta debatojmë këtë apo? Mirë! ok! Mirë!

2. Çështja e përfitimeve të shërbimeve. Në nenin 9 paragrafi 2, pas fjalës “furnizime publike” duhet të shtohet fjalët “shërbime”.

Në ekonominë e tregut në sektorin publik, punët kontraktuese janë të llojllojshme. Një pjesë e madhe të punëve në sektorin publik janë të karakterit shërbyes, andaj shërbimet duhet të parashihen në këtë dispozitë si lloj i veçantë i punëve.

Kësisoj institucionet publike shpeshherë për nevojat e tyre shpallin tendere për kryerjen e shërbimeve të veçanta, për shembull për shërbimet përkthimit, shërbime intelektuale, shërbime juridike etj.

3. Çështja e ushtrimit të veprimtarive në arsimin e lartë publik

Një pikë e cila është debatuar edhe më herët. Në nenin 10 të ligjit aktual nuk është paraparë asnjë ndryshim ose plotësim. Agjencia propozon që në nenin 10, paragrafi 2 të ligjit aktual pas fjalës “arsimit” të shtohet fjala “në sektorin publik”.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik i lejohet të merret edhe me veprimtari shkencore, artistike, kulturore dhe humanitare, por çështjet e arsimit duhet të kufizohen vetëm në sektorin publik. Nuk ka mundësi të gjenden zgjedhje ligjore që do t’u ndalonte zyrtarëve të lartë angazhimin në bartësit e arsimit privat, por besojmë në sektorin publik duhet të vihen kufizime.

4. Çështja e transferit të drejtimit të ndërmarrjes.

Një pikë shumë e ndjeshme edhe jo e qartësuar në ligjin aktual që është në fuqi. Në nenin 14, të projektligjit është paraparë çështja e transferit të drejtës së drejtimit të ndërmarrjes nga zyrtari i lartë publik.

Gjatë ushtrimit të funksionit publik të precizohet saktë përkufizimet se kush është person i besueshëm dhe i afërm. Rrethi i këtyre personave do të duhej të shtrihej jashtë anëtarëve të familjes së zyrtarit të lartë publik. Rrjedhimisht, transferi i të drejtës së drejtimit të ndërmarrjes do të duhej të bëhej te personi i besueshëm me përjashtim në rastet kur janë në bashkë-pronësi dy familjarë, ku zyrtari i lartë publik duhet t'i kërkohet vetëm largimi nga drejtimi ose menaxhimi i ndërmarrjes.

5. Çështja e ushtrimit të funksioneve tjera nga bartësi i funksionit në sistemin e drejtësisë

Në nenin 15 të projektligjit duhet të hartohet një paragraf i ri i cili ndalon ushtrimin e funksioneve tjera për bartësit e funksioneve të sistemit gjyqësor. Bartësve të funksioneve të sistemit gjyqësor siç janë prokurorët dhe gjyqtarët duhet tu ndalohet ushtrimi i funksioneve tjera krahas funksionit që ushtrojnë në sistemin e drejtësisë. Në praktikë është shumë e shprehur dukuria që prokurori dhe gjyqtarët krahas funksionit parësor në sistemin e drejtësisë të ushtrojnë edhe aktivitete tjera, veçmas në mësimdhënie, në bartësit privat të arsimit të lartë, për shkak të peshës që bart ushtrimi i funksionit të prokurorit dhe gjyqtarit dhe me qëllim të përkushtimit të veçantë ndaj profesionit të tyre.

Propozojmë që kjo ndalesë të përfshihet në këtë projektligj me besimin që e avancoon dhe fuqizon sistemin e drejtësisë.

6. Çështja e punësimit të zyrtarëve në 2 e më shumë institucione shtetërore

Në nenin 16 të projektligjit aktual duhet t'i shtohet një paragraf i ri si në vijim: zyrtarit të lartë t'i ndalohet që të ushtrojë më shumë se 2 funksione në sektorin publik dhe personi zyrtar nuk mund të emërohet anëtar i bordit të ndërmarrjeve publike. Zgjedhja e propozuar është në funksion të luftimit të dukurisë së ushtrimit të funksioneve në sektorin publik, raste të ushtrimit të dy e më shumë funksione në sektorin publik ka shumë, andaj është mirë që kjo dukuri negative të ndalohet me ligj.

Po ashtu, kjo zgjedhje i kontribuon ndër të tjera edhe parandalimit të konfliktit të interesit dhe ofron mundësi për angazhimin e më shumë njerëzve të kualifikuar në fusha të ndryshme në sektorin publik.

Po ashtu, ndalesa e emërimit të personit zyrtar si anëtarë i bordeve të ndërmarrjet publike e ruan pavarësinë e ndërmarrjeve publike dhe mundëson ushtrimin më efikas të një funksioni nga personi zyrtar.

Punësimi i zyrtarëve të lartë të dy e më shumë institucione është bërë dukuri në Kosovë për të parandaluar e luftuar këtë dukuri. Agjencia propozon që asnjë zyrtarë i lartë publik të mos ketë të drejtë të ushtrojë më shumë se dy funksione në të njëjtën kohë.

Përjashtimet mund të lejohen, por me ligje të veçanta parashikohet ndryshe për pozita të caktuara ose në rastet kur funksioni i caktuar zyrtarit të lartë publik i është besuar detyra.

Në raportet dhe analizat e bëra nga Agjencia për vitin 2012, del se rreth 900 persona të lartë publik ushtrojnë më shumë se dy funksione në të njëjtin kohë.

Në mesin e këtyre zyrtarëve ka edhe të atillë që kanë tri e deri në pesë e disa edhe më shumë funksione.

Kjo dukuri shkakton monopol në shumë fusha, dëmton buxhetin publik, si dhe ngulfat konkurrencën e mirëfilltë në shumë fusha të jetës.

Problemetnë këtë aspekt janë shënuar në sektorin e arsimit të lartë publik, në administratën publike, në sistemin e drejtësisë dhe atë shëndetësorë.

7. Çështja e mbledhjes së fakteve për trajtimin e konfliktit të interesit,

Në nenin 18 të projektligjit duhet të hartohet një paragraf i ri si në vijim:

“Për zbatimin e masave nga paragrafi 1, i këtij neni nga Agjencia.

1. Kërkon, mbledh, hulumton dhe analizon dokumentacion dhe informacione tjera relevante lidhur me rastin.

2. Kërkon informacione nga persona të përfshirë në rast, dhe

3. Ekzaminon rrethana që kanë lidhje me rastin”.

Në kuadër të veprimtarisë së saj Agjencia kërkon, mbledh dhe analizon dokumentacionin e nevojshëm në bazë të cilit i vërteton faktet nëse ndonjë veprim përbën konflikt të interesit, për të pasur bazë ligjore të ndërmarrësi i këtyre veprimeve procedurale. Është e nevojshme që propozimi të dhënë futet në këtë nen.

Përfshirja e këtij propozimi në projektligj i ofron agjencisë kompetencë ligjore që të hetoj në mënyrë të gjithanshëm rastet e konfliktit të interesit dhe fuqizon pozicionin e saj.

8. Çështja e dëmit të shkatërruar nga vendimet e mara në gjendjen e konfliktit të interesit,

Në nenin 18, paragrafi 14 dhe 15 të projektligjit është paraparë që organi administrativ të deklarohet brenda 30 ditësh nga marrja e njoftimit për masën e dëmit të shkatërruar nga marrja e vendimit në konflikt të interesit.

Paragrafi 15, i këtij neni përcakton se brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit, Agjencia do të nxjerr rregullore për përcaktimin e formularëve për deklarimin, regjistrimin dhe evidentimin e dëmit të shkatërruar nga marrja e vendimit në konflikt të interesi.

Që të dy këto dispozita janë të paqarta. Nuk dihet çka rregullojnë dhe cili është qëllimi i ligjdhënësit. Rrjedhimisht kërkohet nga sponzorizuesi i projektligjit të na ofroj sqarime të nevojshme lidhur me këto dispozita në të kundërtën për të gjetur zbatim duhet të riformulohen dhe të rishikohen, të precizohen dhe të qartësohen në masën e nevojshme në të kundërtën të largohen nga ky projektligj.

9. Çështja e njoftimit.

Çështja e njoftimit të agjencisë nga autoriteti kontraktues për aktivitetin e prokurimit publik.

Në nenin 19, të projektligjit pas paragrafit 1, duhet të shtohet edhe një paragraf si në vijim:

“Me rastin e marrjes së vendimeve që kanë të bëjnë me përbërjen e komisioneve për proceset tenderuese.

Drejtuesi i institucionit ose i autorizuari i tij duhet të njoftoj agjencinë me shkrimë për anëtarët e atij komisioni.

Kjo zgjedhje e propozuar nga agjencia në mënyrë të saktë rregullon dy çështje: Obligimin e institucioneve publike që të njoftojnë agjencinë për aktivitetet e prokurimit dhe të drejtën e agjencisë që të marrë pjesë në këtë aktivitet”.

Kjo pikë është e rëndësishë së veçantë dhe i shërben parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik e cila vlerësohet si fusha me prezencë më të lartë të korrupsionit në vend.

Nëse kjo zgjedhje merr pëlqimin do të harmonizohet me nenin 8, paragrafi 4, të ligjit aktual në fuqi, sepse rregullojnë po thuaj se të njëjtën çështje.

Andaj, neni 8, paragrafi 4 i Ligjit aktual do të fshihet.

10. Çështja e mbajtjes së regjistrit për rastet e konfliktit të interesit.

Në nenin 19, paragrafi 4 të projektligjit është parapara një paragraf i ri i cili obligon agjencinë të mbaj regjistër për raste të konfliktit të interesit dhe masat të ndërmarra nga agjencia dhe institucionet tjera në lidhje me konfliktin e interesit.

Agjencia pavarësisht kësaj, për nevoja të saj mban regjistër të rasteve të trajtuara të konfliktit të interesit dhe të statusit të tyre.

Ky dispozitë është e nevojshme, të precizohet rrjedhimisht, duhet të përcaktohet nëse regjistri i tillë duhet të jetë publik apo të përdoret vetëm nga agjencia për nevoja të saj.

Në fund, duke ju falënderuar për bashkëpunim, kërkojmë që vërejtjet të paraqitura më lartë lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit aktual për parandalim të konfliktit të interesit të merren parasysh dhe të futen në draftin e këtij akti për votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Murtezaj!

Prej këtyre 10 pikave të cilat i përmende, për të 10-at unë jam shumë dakord, për shkak se janë shumë përmbajtjesore dhe do ta përmirësonin dukshëm parandalimin e konfliktit të interesit. Mirëpo që fatkeqësisht nuk janë marrë parasysh nga Ministria e Drejtësisë.

Vetëm pika e parë, pra ka të bëjë me projektligjin aktual, që ne si grup punues kemi mundësi ta ndryshojmë. Mirëpo nëntë pika tjera kanë të bëjnë me ligjin që është në fuqi dhe dorën në zemër ne nuk kemi mundësi që është edhe Armendi këtu dhe nuk kemi mundësi të bëjmë ndryshime në raste të tilla sepse kemi pasur edhe përvoja të tjera që Komisioni për Legjislacion nuk e ka lejuar një gjë të tillë.

Sa i përket çështjes së mbajtjes së regjistrit për rastet e konfliktit të interesit. Kjo parashihet në projektligjin aktual, pra është neni 12, paragrafi 4, ku e obligon agjencinë që të mbaj regjistrin për rastet e konfliktit të interesit, mirëpo pikat tjera nuk janë marrë parasysh fatkeqësisht.

FRASHËR MURTEZAJ: Çështjen e regjistrit, unë desha me shtua edhe atë, është paraparë si regjistër mirëpo nuk thuhet se çfarë regjistri duhet të jetë ai, a duhet të jetë publik a duhet të ju ofrohet publikut në mënyrë elektronike a në mënyrë të shkruar a në çfarë mënyre, për atë mënyrë me ditës se për çfarë regjistri bëhet fjalë.

KRYESUESI: Armend!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Përsëendetje për të gjithë,

Realisht të flasim edhe në bazë të asaj të përvojës që e kemi edhe si deputetë, po thuaj se me gjithë këto që kemi punua edhe në faza të ndryshme.

1. Ndoshta si institucione ta quaj në përgjithësi, mendoj që ka pasur një ecje të lehtë në këtë drejtim, përmirësim të situatave të ndryshme me tendenca më shumë individuale se sa kështu kolektive dhe institucionale të zbatimit të ligjit në këtë fushë.

2. Po e shoh që ky projektligj po vjen shpesh për plotësim ndryshim, vetëm unë sa jam deputetë po më duket hera e tretë ose kjo e katërta është që kemi punua me disa prej juve, shoqëri civile, Ministrinë e Drejtësisë.

Dhe, në kuadër të kësaj mendoj se një prej metave kryesore është e Komisionit për Legjislacion i cili nuk ka mundësi me monitorua zbatueshmërinë e këtij projektligji, kjo është e para. dhe nga ajo ne do të kishim dalë me konkluzione shumë më të sakta t'u i pa edhe nga praktika dhe atë se cilat janë nevojat e vendit tonë si shtet i ri, duke vënë në funksion parandalimin e konfliktit të interesit.

Personalisht mendoj nuk është me rëndësi që ne të hartojmë vetëm çdo vjet legjislacion të ri, e rëndësishme është që ne kemi definim të qartë të pikave se çka po dom me ndryshua dhe çka po dom me arrit në këtë drejtim, cilat janë mangësitë, cilat dëshirojmë të eliminojmë, cilat dëshirojmë t'i avancojmë.

Këto çka i tha zotëri Frashër, unë mendoj që disa prej tyre tash duhet të kenë një studim pak më të hollësishëm edhe pse kështu duke ambicioze, duken të kapshme për neve edhe për ata që mendojnë me të vërtetë të ketë definim të qartë të dispozitave ligjore në këtë fushë.

Unë mendoj që si institucione ne kemi nevojë, kemi amendamente konkrete të cilat nuk lejojnë dualizmin, duke filluar edhe nga fjalët ato më të thjeshta për shembull fjalës shpërblev, në favore domethënë edhe këto që unë i kam theksua nëse nuk gaboju apo personi i afërm, personi i besueshëm sepse pikë së pari merren edhe disa çështje tjera, mentaliteti i vendit, krijimi i institucioneve të reja e të tjera.

Por, e dyta është Agjencia Kundër Korrupsion.

Ne këtu kemi debatua shpeshherë edhe si institucion përkatës, roli i agjencisë, luftimin e korrupsionit, parandalimin e konfliktit të interesit të gjitha tjerat dhe fokusi te zyrtarët e lartë publik.

Këtu duhet shkarkohen nga kjo sepse duhet një nënshtim tjetër të bëhet gjithë sektorit publik jo vetëm te zyrtarët e lartë publike, se po më duket që edhe tendenca edhe e agjencisë edhe e shoqërisë civile, nganjëherë edhe ne vetë neve si politikan e kemi një fokus më të veçantë, fokusohemi Kuvendi, Qeveria, domethënë pjesë tjera po mbesin kaq të shkëputura jashtë rrethit tonë sa që edhe kontrolli parlamentar edhe kontrolli qeveritar po e zë agjencionet e ndryshme, bordet, ndërmarrjet publike e tjerë mbesin jashtë

kësaj veprimtarie dhe dy fusha të tjera që tash nuk janë më temë tabu shëndetësia, sistemi i drejtësisë në përgjithësi si kategori kushtetuese e pavarur dhe arsimi.

Prandaj, unë nuk jam për që kështu blanko të marrim jo vetëm këto plotësim ndryshime që janë bërë edhe këto çka i tha shumë në mënyrë të qartë edhe përfaqësuesi i agjencisë. Ne mendoj që duhet të ulemi të bisedojmë konkretisht, t'i shohim praktikën më të mira të vendeve që janë edhe të rajonit edhe vendeve ndërkombëtare dhe nuk guxojmë të bëjmë eksperimente unë personalisht mendoj sepse kam parë edhe nga praktika që shpeshherë kemi rrëshqitë në eksperimente të caktuara dhe në fund të fundit rezultati ka qenë zero. Rezultati që ka qenë ka qenë përfshirja e të gjithëve, futja e të gjithëve në një thes. Domethënë sikur ai që asnjëherë nuk ka ra ndesh apo të the as në konflikt të interesit apo me shkelje ligjore dhe sikur ai që vazhdimisht ka bërë shkelje ligjore ta quaj dhe nuk ka pas ndëshkime ligjore dhe parafrazimi ka qenë i njëjtë për të gjithë.

Prandaj, unë jam për që të vazhdojmë kështu me punën, po më pëlqen edhe mënyra e debatit edhe dhënia në hapësirë si thash për kolegë dhe të pranishmit. Por mendoj që duhet qartë të dimë çka po bëjmë dhe si po veprojmë.

Unë nuk jam për që të jemi të ndikuar nga aspektet më shumë të jashtme dhe ato çka i quajmë ne proklamimet politike, unë jam për që të punojmë dhe definojmë qartë dispozitat ligjore, parandalimin e konfliktit të interesit, mos lënien hapësirë që njerëzit të vazhdojnë këtë avazin e vjetër, por edhe mos të krijojmë një centralizëm që dikush mund të dëmtohet i cili mund të bie ta quaj, ta quaj prej apo mund të bie në atë grupin e atyre të cilët së paku nuk e meritojnë që të jenë pjesë e asaj.

Kështu që propozimet janë të mirëseardhura edhe në fund e pashë që disa çështje që kanë të bëjnë me rolin e agjencisë. Domethënë për mua janë sinjoralisht janë një avancim i këtij institucioni edhe pse jam shumë ambicioz edhe dyshoj a mundet me bërë agjencia me këto kapacitete, me këtë mbështetje ta quaj edhe prej Kuvendit, edhe mbështetje buxhetore të gjitha, a mund me i krye të gjitha këto detyra, po pa marrë parasysh edhe fushën tjetër që është deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë, këtu përcillet tash që i propozohet të përcjellja e njerëzve pjesë që janë tenderit apo edhe këtu e pash te neni 15, nëse nuk gaboj edhe profesori atë ditë e ka theksua në

seancë plenare nuk e di nxjerrjen e një rregullore për përcaktimin e formularëve për deklaram, regjistrim dhe evidentimin e dëmit të shkaktuar nga marrja e vendimit në konflikt të interesit. Domethënë edhe kjo është një fushë e gjerë e cila bie ndesh edhe me Kodin Penal mendoj ose me Kodin e Procedurës Penale sepse dëmin e përcakton gjykata dhe nuk e di sa mundet tash në bazë të një formulari agjencia me përcaktua një shkaktim, një dëm të llojit të vetë dhe atëherë ky lëndë të përcjellët për gjykatat kompetente.

Sido që të jetë edhe një herë po e përsërisë, e vlerësoj punën e angazhimin por mbes pranë këtyre qëndrimeve që ne duhet të jemi konkret, domethënë të mos egsagjyrohem me shumë në dëshirat e përgjithshme dhe ato çka ndodhim ose çka shohim ne që ndodhin në Kosovë, t'i marrim shembujt e këqij por t'i marrim edhe shembujt e mirë të vendeve që janë të rajonit. Ne nuk mundemi gjithmonë të mbesim peng e keqpërdorimeve dhe njerëzve keqbërës që janë dhe tash të shohim, ta centralizojmë apo ta kufizojmë gjithë sistemin në bazë të legjislacioneve e cila bie ndesh shpeshherë edhe me shkelje të drejtave të njeriut. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, Armend!

Po, profesor.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, Albulena!

Unë e dëgjova dhe prej Albulenës që e përmend, por edhe prej Armendit, se ne sot po diskutojmë vetëm për këtë projektligj dhe mund të bëjmë ndryshime vetëm në dispozitat e këtij projektligji që i kemi këto nene, apo mund të intervenojmë edhe në ligjin aktual. Dhe kisha dashtë edhe mendimin e administratës për të na japë një mendim të cilin e vlerëson që ky projektligj duhet të ketë efektin e vet apo ndikimin e vetë në ligjin ekzistues. Se përndryshe në qoftë se nisemi dhe edhe diskutojmë vetëm atë çka na ka afrua Qeveria atëherë kjo është e kot, po e kotë edhe ky debat, ky tubim dhe ky takim edhe pse jashtëzakonisht shumë po më pëlqen mënyra e debatit dhe jemi shumë të lirë dhe thjeshtë po i përcjellim përvojat, po qëndrimet tona nga përvojat e fituara në praktikë, sepse vlerësoj tek e fundit qëllimi i debatit është që ne t'i kemi para vetes përvojat praktike në mënyrë që të shohim çka ka pozitive nga ato përvoja dhe çka ka negative. Kuptohet, ato që janë anë negative t'i eliminojmë kurse anët pozitive t'i pranojmë.

Prandaj, un jam i interesuar thellësisht te di se cilat janë mundësitë ligjore që segmentet e caktuara, propozimet e caktuara që dalin nga ky debat

pavarësisht që nuk janë të prekura në këtë projektligj, ne t'i inkorporojmë t'ia prezantojmë Komisionit për legjislacion, e më tutje t'i përcjellim në seancë në mënyrë që të mos kemi nevojë pas gjashtë muajve të iniciojmë prapë problemin e njëjtë plotësimin dhe ndryshimin e ligjit sepse na ka ra ndërmend diçka e re.

Po them jashtëzakonisht jam i kënaqur në atë kuptimin apo jashtëzakonisht më pëlqyen propozimet që janë bërë nga ana e Agjencionit Kundër Korrupsionit se vërtetë po shihet që kanë përvojë drejtpërdrejtë me konfliktin e interesit, do të thotë kanë punë me njerëzit të cilët kanë konfliktin e interesin dhe e kanë studiuar, e kanë analizuar mjaftë mirë. Pikërisht për këtë arsye, ky që qëllimi ynë i përbashkët edhe i Ministrisë të Drejtësisë dhe Agjencionit Kundër korrupsionit edhe Shoqërisë civile por edhe i joni si deputetë është që këtë dukuri ta parandalojmë aq sa është e mundur, kuptohet edhe me segmente të luftimit.

Unë po ndalem te dy pika, dhe arsyeja pse po ndalem te këto pika, pika 3 dhe pika 5, është se vërtetë kam njohuri të mjaftueshme nga përvoja praktike, është pika e arsimit të lartë është edhe pika e gjyqësorit apo sistemit të drejtësisë, duke mos anashkaluar edhe pikën e shëndetësisë që në praktikë nuk e njohë por po më duket që është situatë pak a shumë e njëjtë.

Te arsimit të lartë, shumica prej jush keni qenë edhe studentë në fakultete tona, e dini që punoj aty, unë habitem. Pse habitem? Kemi një numër të madh të personave të angazhuar edhe profesor edhe asistentë të cilët në Fakultetin Juridik të Prishtinës, e kanë vetëm marrëdhënien e punës, nuk paraqiten kurrë, nuk i shohë kurrë, a paraqiten ndonjëherë apo jo ndoshta eprorët e tyre, mësimdhënësit e tyre mund ta dinë, prandaj për mua është drejtpërsëdrejtë një konflikt interesi.

Dhe thotë këtu nuk ka mundësi të gjendet zgjidhje ligjore që do t'ju ndalonte zyrtarëve të lartë angazhimin në bartjen e arsimit të lartë privat, por besojmë se në sektorin publik duhet të vihen kufizime.

Pajtohem me atë, mirëpo kufizimet duhet të jenë edhe në arsimin e lartë sepse kemi pasur një tendencë të tmerrshme në fakultetin tonë. Themeluesit e arsimeve të larta për shkak të konflikteve të ndryshme për shkak, po flas jo konflikte por për shkak të interesave të ndryshme në ndërkohë janë angazhuar dhe që është ky një konflikt interesi sepse prapa tyre qëndrojnë

veprimet manipulativë korruptive pse unë po ta mundësoj ty brenda natës me u bë këtu, ti ma paguan mua atje dhe interesi kurse dëmi është interesi i përgjithshëm publik sepse po vjen një kuadër i cili ka të bëjë atje me arsim privat, le të rijë e ka themeluar qysh e ka themeluar me çfarë dispozitash, por jo të kemi konflikt të tillë.

Prandaj edhe këtu është mirë kjo lëmi të rregullohet edhe pse është Agjencioni për Akreditiv të institucioneve të arsimit të lartë që pak a shumë na e ka lejuar të kemi një gjysmë normë, një gjysmë normë është e rregulluar me ligj por kjo çështje të shikohet.

Në anën tjetër, unë nuk di a ka mbetur ndonjë gjykatës dhe ndonjë prokuror i cili nuk është angazhuar, i cili nuk është angazhuar në arsimin e lartë. Në anën tjetër atë raportin e progresit që u përend më herët thotë se ka 250.000 lëndë të pazgjedhura, prandaj je përcaktuar për sistemin gjyqësor, të lutem ai është funksioni primar i tërësishëm dhe gjithkund në botë veprohet ashtu, gjithkund në botë prokurori e ka një detyrë të vetme e jo të ngajë nëpër universitete private, nëpër institute, nëpër publike private e tjera e tjera e ka po i mbetet për kohë për drejtësi, i mbetet t'i grumbullohen lëndët, andaj jam i asaj çështjeje që të rregullohet, jemi përcaktuar për mësimdhënës. Unë për vete më së pari po flas se e kemi pasur një profesor dhe është shumë profesor i ndershëm Hivzi Sojeva, në ditën e caktuar menjëherë ka dhënë dorëheqje është kthyer në fakultet sepse ka vërejt konflikt të internist kurse disa të tjerë, prandaj mos ua lëmë në ndershmërinë apo në pandershmëri sepse tek e fundit ndonjëherë e shohim që unë po tërhiqem, ai nuk po tërhiqet atëherë pse a unë jam andej... nuk duhet t'ia lëmë na në vullnetin e lirë, por sendet e tilla të rregullohen çështje të ndryshme shumë të rëndësishme nëpër ministri që njerëzit e arsimit i mbajnë pse të koncentrohet për pushtetin e mirë. Le të urdhëroj nëse donë edhe tjetrën po e them pagat në Universitetin Publik të Prishtinës, në arsimin e lartë janë jashtëzakonisht të mira. Pagat sa për ta mbajtur një familje, sa për ta zhvilluar këtë, e tash në kokën kur kemi një papunësi kaq të madhe në Kosovës dikush ta ketë luksin t'i ketë 3 e 4, ose 5 pozita, kurse dikush të mbetet duke bredhë rrugëve me diplomat e njëjta, duke kërkuar punë, aj faj është te na, ne duhet të mendojmë si institucion, si shoqëri si Kuvend ta rregullojmë e secilit t'i bëhet me dije je punësuar profesor në fakultet, por punoje punën tënde si profesor, je punësuar si asistent, puno angazhohu dhe bëhu sa më shpejtë profesor dhe jo me nga nëpër ministri apo nëpër zyrtare ligjore, administrata e ku ta di

unë pozita të tjera, leja një kolegut tënd një vend të tillë, një mundësi të tillë që të jemi një trajtim të barabartë në kuptimin e konkurrencës.

Edhe një çështje tjetër, për shëndetësi, përafërsisht është situata e njëjtë. Nuk kam informata shumë, por e di se ka sidomos angazhime në arsimin e lartë, në sektorin e shëndetësisë, ata mos gabofsha e kanë diku 400-500 të punësuar, është fakulteti më i ngarkuar, kurse të njëjtit njerëz kanë firma private, kanë ambulanca private, kanë barnatore private, kanë veprimtari private kurse fakultetin e shfrytëzojnë vetëm si një lloj trampoline, ose janë në ÇKUK, e shfrytëzojnë bile, bile nganjëherë është përfolur pra për t'i dërguar pacientët të cilët nuk punojnë prandaj aty merren, bëhen kufizime edhe pse këtu duhet me pa Ligjin mbi shëndetësinë që është e rregulluar. Ka qenë një propozim i tillë edhe nga ana e vetë ministrit nëse nuk gaboje, por duhet të shohim konfliktin.

Po dal edhe në një çështje tjetër që në ndërkohë e përmendi edhe Frashri, çështja e angazhimeve nëpër bordet e ndryshme Ne javën e kaluar kemi qenë në një komision së bashku me Armendin në një komision punues dhe kemi parë njerëzit të cilët kanë nga dy funksione, vijnë konkurrojnë edhe për funksionin e tretë, andaj edhe ajo mënyrë të rregullohet me ligj. Je në një funksion, e ki një punë, punoje atë punë si duhet edhe në bordet publike të jenë të angazhuar ata të cilët nuk kanë angazhime tjera primare dhe ta kenë atë si primare ose le të vlerësojnë ata vete a dëshiron në Bord ku ka rroga nganjëherë shumë të majme me, mos t'i përmendi shifrat se nuk jam i sigurt por e di se kam parë diku rrogë të majme, apo dëshiron sepse bordet i shfrytëzojnë vetëm nga një mbledhje në javë. Tash po ju them edhe këtë shembull po ua tregoj nga përvoja ime personale që e kam pasur dhe kam qenë anëtarë i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës si mësimdhënës në bazë të statutit ka qenë e paraparë dhe në kohën kur kemi pasur takime, një prej anëtarëve të bordit pat deklaruar: hajde t'ia bëjmë rrogat vetit nga 1000 se Bordi i KEK-ut dhe Bordi i RTK-së dhe Bordi i Aeroportit i kanë nga 2-3000 e pse na nga 1000 jo për çka për një mbledhje të vetme që e kemi pasur, një mbledhje të vetme do me thënë për një mbledhje të paguhet 1000 euro. Disa kemi kundërshtuar, dihet janë procesverbalet që kemi kundërshtuar. Pozitë më e keqe se me ia caktua njeriu vetes pagën nuk kish. Patëm kërkuar në atë kohë ndihmën e Ministrisë së Arsimit dhe na kanë dal me një prapë angazhime, duhet diçka të paguhet apo të shpërblehet, por jo të shkohet në mënyrë të tilla, në mënyrë drastike apo astronomike apo në mënyrë shumë të latë dhe mendoj

se është mirë është ë derisa i kemi nëpër dorë këtë ligj që mos trajtojmë menjëherë t'i shohim eventualisht ato pengesa pse nuk mundemi, mundemi vetëm t'i analizojmë si duhet dhe t'i inkorporojmë këto vërejtje, pastaj njerëzit le të përcaktohen, duke nisur nga vetja ime a dua fakultet, a dua Universitet apo dua edhe institucione, edhe shoqëri civile edhe kjo edhe tjera, kurse të tjerët të bredhin rrugëve me diploma të njëjta siç i kemi ne.

KRYESUSJA: Faleminderit, profesor! Fehmi a po na shpjegon apo Visar çështjen?

(Ndërhyrje: S'ka dert, e kemi të qartë këtë. S'është problem, se u përmend dy-tri herë prandaj unë e ngrita.

ARMEND ZEMAJ: Jo kërkojë falje ndoshta nuk kam dëgjuar...

 : Jo, jo, hiq s'është problem. Se u përmend dy-tri herë kjo çështje prandaj unë e ngrita.

ARMEND ZEMAJ: Unë e mendova në atë aspektin që i trajtova si propozime dhe parimisht u pajtova, thash janë propozime ambicioze dhe e dyta ne mund t'i nënshtrohem edhe punës në Komision. Afati ligjor kuptohet sipas Rregullores së Kuvendit është dyjavor për propozimin e amendamenteve, por kjo nuk e parandalon që Komisioni me vendos me krijuar amendamente të caktuara ose me i pranuar, varet në formë dhe se si ne i bëjmë.

E dyta. Kjo vetëm i nënshtrohet një konsultimi më të gjerë bashkërisht me sponsorizuesin edhe me Agjencinë Kundër korrupsion dhe në ka asnjë të keqe e këto të inkorporohen pjesë e Projektligjit, kështu që procedurat ligjore nuk e parandalojnë edhe pse realisht është një praktikë e ndërtuar e cila nuk është e shkruar që plotësim-ndryshimi i nënshtrohet vetëm amendamenteve të cilat janë në plotësim ndryshim, ndërsa procedura tjetër, realisht është praktikuar që të kthehet prej fillimit atje te sponsorizuesi mendimi, çka ka dashur, qëllimi dhe të gjitha tjerat, por në fakt brenda si objekt ne mund të punojmë dhe mund të marrin edhe amendamente të caktuara çfarë mendon se Komisioni mundet me i inkorporuar pjesë e këtij Projektligji.

KRYESUESJA: Faleminderit Armend! Fehmi, a po do me marrë fjalën edhe ti?

FEHMI HYSENI: ... do të thotë shqyrtimi i Projektligjit në Komision, prapë që e kemi në këtë projektligj. Po e lexoj ta zëmë paragrafin 4: propozimi për amendamente duhet të përmbajë referimin ndaj dispozitës të projektligjit, formulimin e saktë të amendamenteve dhe arsyetimi i ndryshimit të propozuar, do të thotë saktë është në dispozitë projektligji por jo të ligjit bazik.

Kjo thjeshtë është, që në këtë projektligj na mundemi me e ndryshuar si Komision qysh të doni këtu, por nuk guxojmë na me e prekë ligjin bazik, ligjin ekzistues që është sipas kësaj Rregulloreje të Kuvendit, e mirë, e keqe kjo që është por qashtu është. Qe mundesh prof...

KRYESUESJA: Faleminderit Fehmi!

Edhe nuk jam dakord me këtë dispozitë për shkak se kemi pasur praktika edhe më herët ku nuk ka është lënë me e ndryshuar ligjin që është në fuqi, mirëpo kjo e ka vështirësuar shumë punën e Komisionit për Legjislacion, jemi bërë më si Komision teknik sa që propozimet e Qeverisë adresojnë në Kuvend, çështjet teknike përmirësojë dhe ja këto janë amendamentet, kjo është e palogjikshme që po thotë profesori, mirëpo kemi mbetur të varur nga dispozitat e Rregullores.

ARMED ZEMAJ: Meqë na kemi debatuar tash edhe, se po dalim pak jashtë kontestit. Gjatë hartimit të Rregullores së tretë të punës së Kuvendit, se ne e kemi paraparë çka është ai amendamenti 57 i Rregullores, paragrafi 3-4 nëse nuk gabo, procedura që është neni i asaj. Në fakt të gjitha ligjet, asnjë ligj nuk vjen për plotësim-ndryshim projektligje quhen dhe referimi i dispozitës është vetëm te qëllimi sepse ne e kemi këtë praktikë por nuk është që nuk e ka përdorur Komisioni por nuk mundet me ndryshuar diçka çka është me qëllimin i cili ka kaluar në parim, do me thënë në lexim të parë. Kjo është esenca dhe praktika që përdoret edhe në komisione edhe në raport me sponsorizuesin, por nëse amendamentet e caktuara e ndryshojnë komplet përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, neve nuk mundet askush me na ndaluar që me e hartuar edhe legjislacion, nismë ligjore do me thënë është e njëjtë, plor në fund të fundit unë e thash atë në fillim, e përsërita tri herë. Kjo gjithçka bëhet në bashkëpunim me sponsorizuesin në këtë aspekt që është Qeveria apo edhe implementuesi që

duhet të jetë te Agjencia Kundër Korrupsion, vetëm kjo kërkohet. Nëse këto tri kompetente bijën në ujdi edhe politika edhe ekzekutivi që kjo duhet të jete, kjo nuk e parandalon në bazë të Rregullores të Punës së Kuvendit që të inkorporohen dhe të jenë pjesë e Projektligjit.

HAKI DEMOLLI: Unë lidhur me atë dispozitë thash duket e palogjikshme. Vetëm po e marrë vetëm një shembull. Në qoftë se ky Projektligj ka vetëm një nen, ngritë vetëm një çështje të caktuar por ne si Komision por edhe ne si debutues të debatit publik dimë se i njëjti ligj, ai ligji primar i ka edhe nja dy-tri defekte tjera që janë paraqitur në praktikë, atëherë do të thotë ne mund të diskutojmë vetëm për atë nenin përkatës, për atë propozimin përkatës që ka ardhur nga sponsorizuesi por jo edhe për ato dy tjera. Të paktën kështu, andaj më duket e palogjikshme sepse, nëse e trajtojmë një ligj pse jo ta trajtojmë në çdo aspekt përfshirë kuptohet edhe amendamentin sepse sponsorizuesi e ka përcjellë më për së afërmi, i di qëllimet, i di objektivat, i dinë arsyet që i theksoj në fillim zëvendësministri, mirëpo pse mos të trajtohet dhe të mbetet edhe herrave tjera të ngritën iniciativa tjera. Por sido kudo ne veprojmë ashtu sipas dispozitës se nuk jam për me i shkelur dispozitat me këshillat dhe instrukcinet që i dha edhe Armendi, në mënyrë që ky projektligj apo ky ligj i cili aprovohet me këto ndryshime, pra e kam fjalën për Ligjin për konfliktet e interesit, të jetë sa më praktik, sa më i zbatueshëm dhe të jetë sa më funksional.

KRYESUESJA: Faleminderit profesor! Urdhëroni!

ETRUR MALOKU: Faleminderit kryesuese! Përshëndetje për të gjithë, jam Ertur Maloku, nga Ambasada e Amerikës.

Unë po mundohem me iu përmbajtur vetëm këtij projektligji këtu, me disa komente të shkurta. Mendoj se ky ligj apo projektligj që është propozuar këtu i përmbushë 3 objektiva deri diku.

E para, është rritja e transparencës dhe e llogaridhënies të personave zyrtarë, që mendoj unë është diçka pozitive dhe duhet me u lavdëruar.

E dyta, ka të bëjë me harmonizimin me dispozitat e Kodit penal, që i ka. Pak më herët dëgjova përfaqësuesin nga Agjencia Kundër Korrupsion që tha –

ne nuk mundemi me shkuar me këtë përkufizim, e propozoi një përkufizim tjetër për personin zyrtar.

Po problemi që na del, nuk e di sa është e mundur ligjërisht, sepse në Kod penal atje që e miratuan në vitin e kaluar në Kuvend të Kosovës këtu është një dispozitë kalimtare ku thotë: Kodi penal ka përparësi ndaj çdo ligji tjetër i cili bie ndesh me të. Domethënë, në këtë rast kishte me mbet një dispozitë e vdekur, faktikisht normë e pazbatueshme.

Dhe, e treta, është sqarimi apo qartësimi i dispozitave të paqarta, që mund të jetë edhe e karakterit teknik në këtë projektligj por besoj që i sqaron disa çështje.

Unë e kam një shqetësim këtu te përkufizimi dhe nuk e di, nëse munden me u adresua, kjo ndoshta është për komisionin që ta vlerësojë por përkufizimi i personit zyrtar aktualisht duhet personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ shtetëror. Këtu nuk e di, a hyjnë zyrtarët e prokurimit ose personat që e udhëheqin departamentin e prokurimit dhe atë të departamentit të financave sepse ata nuk janë as persona të zgjedhur as nuk janë persona të emëruar. Ata janë shërbyes publikë ose shërbyes civilë të cilët rekrutohen dhe punësohen në bazë të Ligjit për shërbyes civilë dhe ligjet tjera që janë në fuqi.

Janë edhe dy paragrafë tjerë të cilat e zgjerojnë këtë bazë, por që ndoshta janë të paqarta dhe munden me lejuar ose lejon hapësirë për interpretime të ndryshme. Ndoshta këtu kishte me qenë mirë të specifikohen pak më shumë dhe të qartësohet saktësisht se a hyjnë edhe këta shërbyes civilë apo jo. Kaq, dhe nuk po e zgjas më shumë.

KRYESUESI: Faleminderit Etrur! A ka edhe ndokush tjetër që dëshiron fjalën? Urdhëro!

BAKI GIMOLLI: Nga Ministria e Drejtësisë! Nëse më lejohe vetëm një sqarim të shkurtër. Për ata që s'më njohin, jam Baki Gimolli, udhëheqës i Divizionit për Legjislacion.

Fatmirësisht, kam marrë pjesë edhe vet në hartimin e këtij projektligji dhe në krahasim me hera tjera kemi qenë shumë fokusuar që të jemi sa më shumë transparent.

Nuk po dua të lëshohem aq shumë në historianin e hartimit të këtij projektligji, po dua t'i ceku tri çështje shumë të rëndësishme.

E para është që, sa i përket çështjeve teknike që po përmenden, unë nuk do të thoja se janë çështje teknike, sepse fusha penale dhe fusha e kundërvajtjes janë dy fusha shumë të rëndësishme, që do të thotë e determinon faktin se nuk është teknike.

Çështja tjetër, te Agjencia, do të thotë, Agjencia Kundër Korrupsionit, fillimisht po e potencoj se Ministria e Drejtësisë nuk i ka marrë për bazë që të hartohet një ligj i ri.

Ne i kemi thënë edhe një herë Agjencisë që ne jemi duke e zbatuar Rregulloren e punës të Qeverisë, që Rregullorja parasheh se nëse kalon 40% të shkojë ligji i ri. Domethënë ... sa është e atij mandati.

Përfundimisht, pasi që e kemi hartuar këtë projektligj, ne si Ministri e Drejtësisë, në momentin para se me e adresuar në Qeveri, të njëjtin projektligj e kemi dërguar edhe një herë tek Agjencia për të marrë edhe një herë një qëndrim të tyre për çka shumë propozime që ne këtu s'i kemi nuk i kemi poseduar, do të thotë, në grupe punuese, kështu që ne jemi të hapur për çdo vërejtje, sugjerime apo për çdo dispozitë që ta harmonizojmë.

I rëndësishëm është një fakt që fillimisht duhet të kuptojmë se Kodi Penal është ligj material, që profa e di, në lëmin penal dhe dispozita materiale është ajo që nuk mund të jetë nën dispozitën procedurale, prandaj krejt dispozitat tjera vetë këtë... do të thotë material, ia ka determinuar se është e pandryshueshme dhe ky na ka bërë që edhe përkufizimet për persona fizikë të harmonizohen me Kodin Penal.

Ky ka qenë edhe synimi ynë, për çka ne për çdo dispozitë, edhe në grupe punuese mund të japim argumente e sqarime për çdo koment apo sugjerim.

Unë mendoj që si koncept, si tërësi i këtyre propozimeve, ka vend që të diskutohet dhe sqarohet dhe se unë jam i bindur që shumica e tyre janë të mbuluara. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit zotëri Gimolli! Urdhëro Arton!

ARTON DEMHASAJ: Faleminderit! Për tu ndërlidhur me zotëriun Baki, nëse në grupet punuese - që kemi punuar bashkërisht, së bashku me UNDP, me Ministrinë e Drejtësisë, me Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe me institucionet tjera - të ishin marrë parasysh këto rekomandimet që po i thotë Agjencia tash dhe ne si shoqëri civile jo që kishte kaluar 40% e projektligjit përkatësisht ligjit aktual por edhe përmbi 50%, kështu që kishte mund të fillohet iniciativë të nxjerrët projektligj i ri, mirëpo nuk ka qenë disponimi që të fillohet me një ligj të ri, por të bëhen këto ndryshime.

Arsyeja pse ne po i quajmë këto ndryshime teknike janë se nuk ka një ndryshim thelbësor të ligjit aktual. Pra, është vetëm harmonizim i disa dispozitave të këtij ligji me Kodin Penal sepse tash është bërë vepër penale konflikti i interesave. Domethënë janë disa çështje në harmonizim dhe disa çështje teknike ku hiqet një presje, vendoset një pikë, shtohet një fjali, pas një fjalie vendoset edhe një fjalë tjetër, domethënë nuk ka ndonjë çështje thelbësore që po ndryshohet në ligjin aktual. Për atë arsye ne po i quajmë si çështje teknike, sepse e dimë që çështjet penale dhe kundërvajtjet nuk janë teknike mirëpo ndryshimet që ky projektligj ia bën ligjit aktual janë teknike. Domethënë kjo është ajo që desha të them.

Dhe, nëse vetëm më lejohet të flas edhe për atë se a mundet komisioni a jo për legjislacion të bëjë ndryshim. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës është institucioni që bën nxjerrjen, hartimin dhe miratimin e ligjeve.

Andaj unë mendoj që në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës Komisioni për legjislacion mund të ndryshojë komplet ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, duke filluar prej fillimit deri në fund, sepse e ka këtë kompetencë kushtetuese, edhe pa e dërguar një propozim Qeveria ose Ministria e Drejtësisë, sepse është institucion që i nxjerr ligjet.

Nëse ekziston vullneti i Komisionit për legjislacion për ta ndryshuar këtë ligj prej fillimit deri në fund, mund të merret një iniciativë e re, fillohet të përfshihen edhe këto të këtij projektligji, edhe këto që i propozoi Agjencia edhe këto që i propozojmë ne si shoqëri civile dhe të hartohet një ligj i ri që njëherë e përgjithmonë do të thotë ta rregullojë fushën e parandalimit të konfliktit të interesit prej fillimit deri në fund. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit Arton. Jam shumë dakord që Komisioni për legjislacion e ka të drejtën e nismës, pra legjislative, në këtë rast të një ligji të ri për parandalimin e konfliktit të interesit ku do t'i parashihte të gjitha këto të cilat u përmendën sot këtu, por edhe tjerat për të cilat ne nuk jemi ende në dijeni.

Mirëpo, në këtë projektligj ne tashmë i kemi marrë të gjitha vërejtjet dhe besoj se Visari i ka parasysh të gjitha dhe çka do që do të mund të bëjë grupi punues për ta avancuar këtë projektligj ne do t'i kemi parasysh ato vërejtje dhe besoj që edhe Agjencia kundër Korrupsionit dhe shoqëria civile po edhe Ministria e Drejtësisë do të jetë pjesë e grupeve punuese në mënyrë që ta kemi një ligj sadopak më të avancuar. Nëse s'keni diçka tjetër, unë do tu kisha falënderuar. Po, urdhëroni!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

DAUT XHEMAJLI: ... shumë çështje, e shumë konkrete. Ju e dini sa puna është nëpër institucione dhe zyre të prokurimit për t'i harmonizuar, do të thotë këto komisione, të jenë personat kompetentë e tjera, plus konflikti i interesit atje dhe me bë me ia nisë me i dërguar letra agjencionit dhe me e ngakruar agjencionin se kush e cili komision do të bëhet, unë nuk di çfarë do të shndërrohet Agjencioni Kundër Korrupsionit, pastaj.

Por kjo vetëm ishte një diçka që është tepër ambicioze, që e thatë edhe ju, që do të thotë del jashtë krejt fushës së veprimit. Secili institucion i ka përgjegjësitë e veta.

Unë mendoj, që edhe më herët u tha, që tash i është dhënë një e drejtë, një detyrim mund të themi, Agjencionit për t'i bërë edhe kallëzimet penale. Ata edhe sipas zyrës zyrtare munden, por e keni parasysh sipas detyrës zyrtare, ata formularët prokuroritë nuk i hulumtojnë, që raportohet për konfliktin e interesit, prandaj unë mendoj që kjo është një produkt shumë i mirë. Ka hapësirë të vogël për të interferuar, për të precizuar saktë ndonjë dispozitë, dhe besoj se ne jemi të hapur në këtë aspekt dhe kurrëgjë s'na pengon, pa asnjë përjashtim, cili do institucion në kuptim që ky ligj ose ky produkt të jetë në fushën që lejohet, do të thotë, pra plotësimi dhe ndryshimi të jetë komplet dhe i qartë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Urdhëroni!

FRASHER MURTEZAJ: Faleminderit! Lidhur me këtë çështje, ne edhe në grupe punuese e kemi diskutuar përse duhet të futet kjo. Aktualisht nuk e obligon kurrkënd me e njoftuar Agjencinë për një çështje tenderuese. Mirëpo Agjencia me ligjet në fuqi që është e ka të drejtën me marrë si vëzhgues në secilin proces tenderues.

Atëherë për të mos u lënë hapësirë zyrtarëve që ka të bëjë me parandalim të korrupsionit në tërësi, e kemi menduar se duhet futur atë që të obligohen ata që në raste kur dyshohet me e njoftuar Agjencinë për të marrë pjesë, jo me u lënë hapësirë që ata të thonë jo ne s'kemi qenë të obliguar ta njoftojmë Agjencinë.

(Ndërrhyrje – nuk dëgjohet qartë për transkriptim)

KRYESUESJA: Faleminderit që keni qenë pjesë në këtë dëgjim publik dhe shihemi në takime tjera të grupit punues.